



RENOFIX 20

LLAÇ THEMELOR NGA ÇIMENTO - REZISTUES NDAJ UJIT PËR MURE ME LAGËSHTI

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT

Llaç themelor për suvatim të mureve të brendshëm dhe të jashtëm (fasadave), si llaç për cokle, për bazamente të mbingarkuara nga lagështia dhe suvatim në hapësira të ftohta dhe me lagështi. Përdoret mbi të gjitha llojet e bazamentit normal, mbi beton të vrazhdë, si llaç për suvatim të shatave dhe llaç për mure të bodrumeve.

PËRMBAJTJA

- Çimento
- Rërë karbonati me granula nga 0-1.2 mm
- Shtesa të cilat e përmirësojnë cilësinë

VEÇORITË

- Rezistues ndaj ujit (nuk e lëshon ujin)
- Kualitet i lartë i përpunimit
- Rezistueshmëri të përhershme ndaj ujit

PËRGATITJA E BAZËS

Bazamenti duhet të jetë i sheshtë (i rrafshuar), i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe vajrat. Testimet e bazamentit bëhen sipas EN normave. Udhëzimet e përpunimit janë të vlefshme për muret që janë të ndërtuar me norma të caktuara dhe që nënkuptojnë mure me fuga dhe çarje të mbyllura. Nëse bazamenti ka fuga të hapura apo çarje, të njëjtat paraprakisht duhet të mbyllen (armohen) me Renofix 5 ngjitëse ndërtimi dhe rrjetë armuese. Sipërfaqet e absorbueshme paraprakisht duhet të lagen me ujë.

PËRGATITJA E LLAÇIT

Një thes Renofix 20 zbrazet në 8-8.5 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser për 2 minuta. Nëse përgatitet me makinë, atëherë llaçi përgatitet me makinën e llaçit Skure-Tech S4.

PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT



Gjatë përpunimit me dorë të llaçit, i njëjti vendoset me mistri dhe rrafshohet. Gjatë përpunimit me makinë, materiali vendoset (shpricohet) me makinën e llaçit Skure-Tech S4. Pas vendosjes, materiali sheshohet me sheshues (rrafshues) alumini. Trashësia minimale e shtresës është 10 mm, por nëse është nevoja mund të vendosen disa shtresa të llaçit. Në raste të tilla duhet që shtresa e vendosur paraprakisht të thahet 1-2 orë. Mbi sipër-



PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT

faqet e lëmuara të betonit detyrimisht përdoret Renofix 5 ngjitës ndërtimi si llaç lidhës (beton kontakt) dhe më pas vendoset shtresë e Renofix 20 (e lagur në të lagur). Materiali shfrytëzohet brenda 2 orëve. Gjatë kohës së ngurtësimit (lidhjes), duhet të sigurohen kushte të mira për tharje dhe ngurtësim. Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5C. Nuk lejohet përzjerja me materiale tjera.

VËRREJTJE

Për udhëzime të hollësishme të sigurisë, këshillohuni me fletët e veçanta të sigurisë. Ju lutemi lexoni broshurën e sigurisë para përdorimit.

PAKETIMI

Renofix 20 furnizohet në thasë letre nga 40 kg që janë të mbrojtura nga lagështia.

DEPONIMI

Ruani në një vend të thatë (nëse është e mundur në paletë druri). Afati i deponimit: 6 muaj sipas Rregullores 1907/2006/EU, Shtojca XVII në 20°C, 65% l. r. e ajrit.

TË DHËNA TEKNIKE

Numri i prodhimit	5319990620118
Shifra e prodhimit	1020
Thasë në paletë	30
Njësia sasiore	40 kg / Thes
Granulacioni	1,2 mm
Sasia e nevojshme e ujit	ca 8-9 l./thes
Trashësia minimale e shtresës	10 mm
Harxhimi	Për trashësi prej 10 mm, 15 kg/m ²
Shënim	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10)	ca 1500 kg/m ³
Përcjellshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002):	ca 0.54 W/mK
Vlera - pH	ca 12
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11)	ca 6.0 N/mm ²
Elasticiteti pas 28 ditëve (EN 1015-11)	ca 2.8 N/mm ²
Reagimi gjatë djegjes EN (13501-1)	A 1
MG (EN 998-1):	GP CSIII W0 2

Të gjitha të dhënat për materialin pushon së qeni e vlefshme pas lëshimit dhe sa më sipër listë. Këto janë të dhënat që rezultojnë nga rrymat e analizave. Jo ligjore mund të lindë detyrimi këto të dhëna. Produktet RENOVA, si dhe të gjitha të papërpunuara materialet e përfshira në ato i nënshtrohen të vazhdueshme teste për të siguruar konstante dhe të njëjtin nivel të cilësisë. Këshilltarët tanë teknikë janë në dispozicionin tuaj çdo kërkesë lidhur me Aplikacionin, përpunimin, dhe prezantimin e tona produktet. Ju mund ta gjeni të dhënat tona aktuale në www.renova.com.mk, si një "PDF" dokument ose pyesni për ta në dyqane me pakicë.

RENOVA MAQEDONI
Xhepcisht / Tetovë
Tel: +389 44 487 300
Fax: +389 44 487 200
info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPERI
Picar / Vore
Tel: +355 48 301 909
Fax: +355 48 301 908
tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVË
Gurëza / Ferizaj
Tel: +381 290 310 222
Fax: +381 290 310 444
ferizaj@renova.com.mk

